

II.PRAKTIKA TË MIRA PËR TË NXËNËT NË KLASË NGA MËSUESIT E EKIPIT LËNDOR TË ARTEVE DHE TË EDUKIMIT FIZIK

1.METODA “DIAGRAMI I VENIT”

Në orën mësimore të lëndës Muzikë, klasa e 9A, me temë mësimore: Kënga “Rrjedh në këngë e ligjërime” teknika e ‘diagramit të Venit’, e parashikuar në planin e orës mësimore, bëri që të gjithë nxënësit të përfshiheshin në të nxënë, sepse diagrami ku u shkruajt fjala “Atdhe” ishte një pikënisje e mirë për të kuptuarit e përmbajtjes dhe tematikës së këngës. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Secili/a nxënës/e shtonte nga një fjalë në diagram dhe diskutimi në klasë u zhvillua duke përfshirë paraqitur emocione dhe ndjenja atdhedashurie, mendime për traditat, për zakonet, vallet, këngët dhe figurat më të njohura, historike.Diskutimi zgjati 20 minuta dhe diagrami u mbush plot me fjalë nga nxënësit.
- Pati dhe ide ndryshe gjatë diskutimit për çështje të trajtuara, të cilat nxitën të menduarit, ku me rëndësi ishte që secili/a prej tyre u mundua të mbronte idenë e vet me argumente.
- Kalimi më pas tek mësimi i këngës u bë shumë më i thjeshtë, sepse nxënësit ishin të përfshirë me tematikën e këngës.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh teknikën e e diagramit, sepse ajo i përfshin nxënësit në diskutime për temën e mësimin, si dhe edukon respektimin e mendimit ndryshe.

Mësuesi i edukimit muzikor: Endri Llaha endri.llaha@gea.edu.al

2.METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës art pamor, klasa e 3C, me temë mësimore "Qyteti im i bukur" dhe me koncept kryesor bashkëpunimin, diskutimin/krijimin, metoda e punës në grupe, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë.Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Klasa u nda në grupe me nga 2 ose 3 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat për anëtarët e tij, si dhe secili grup u pajis me fletë të mëdha të bardha, shënjuet me ngjyra/markers, baltë/argjil, bojëra, penela, lapsa me ngjyra, ngjitës letre etj.
- Secili grup punoi për detyrën *e pikturës, vizatimit, kompozim dhe vazo argjili*. Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili/a nxënës/e, por dhe unë si mësuese i kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 10 minuta.
- Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup me nga 5 minuta, u vu re që ekspozita e tyre ishin mbresëlënëse dhe përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënit që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja e artit pamor: Aurela Prifti aurela.prifti@gea.edu.al

3. TEKNIKA “TË PYETURIT”

Në orën mësimore të lëndës Muzikë, klasa e dytë, me temë mësimore kënga “Nata iku ” u përdor teknika e të pyeturit, e parashikuar në planin e orës mësimore, e cila mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshiheshin në mësim, sepse pyetjet e bëra nxitën imagjinatën dhe rritën dëshirën tek secili prej tyre për të shprehur mendimet e tyre. Teknika u zbatua në këtë mënyrë:

- Zgjedha disa pyetje të lidhura me tematikën e këngës “Nata iku “të cilat ishin: Cila është ëndrra e fundit që keni parë? Po ajo më e bukura? Cila është ëndrra juaj më e madhe? Në këngë flitet për yjet që ndriçojnë natën, çfarë ndjeni kur shikoni yjet në qiell që shëndrisin aq bukur? Teksa i shihni a filloni të ëndërroni ?
- Përgjigjet e nxënësve për secilën pyetje ishin surprizuese , plot emocion dhe e gjithë teknika pyetje -përgjigje zgjati 15 minuta.
- Kjo teknikë padyshim që më ndihmoi shumë pasi u shtua kurioziteti i nxënësve për të mësuar këngën hap pas hapi. Vazhdimi i mësimit ishte shumë i thjeshtë pasi ata ishin futur në “botën “ e këngës dhe e kuptuan lehtësisht tematikën që ajo trajtonte. Interpretimi i këngës erdhi shumë natyrshëm më pas prej tyre pasi gjëndja ishte krijuar që në fillim të mësimit nga pyetjet e bëra .

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh teknikën e të pyeturit pasi kjo teknik i nxit nxënësit , shton kuriozitetin e tyre për temën e mësimit , dhe rrit pjesmarrjen në klasë .

Mësuesja e edukimit muzikor: Klaudia Hazizanj klaudia.hazizajn@gea.edu.al

4. METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës Teatër, klasa VB, me temë mësimore ‘Interpretim me maska’ dhe me koncept kryesor ‘Nxënësi interpreton duke respektuar elementet teatror’ u përdor metoda e punës në grupe, e parashikuar në planin e orës mësimore, e cila më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Përzgjedha tre nxënës për secilin rresht, si dhe secili/a nxënës/e përzgjedhi një fabul ose përrallë, nga e cila nxirrin numrin e aktorëve që përbëjnë pjesën. Klasa u nda në 3 grupe.
- Secili nga nxënësit, të cilët u përzgjedhën në fillim për të përzgjedhur një përrallë nxorën elementet teatror si regjisor të vërtetë filluan të përzgjedhin nxënësit duke i përshtatur me karakteristikat e rolit.
- Dy grupet e para zgjedhën përralla të vjetra, kurse grupi i tretë vendosi ta krijonte vetë këtë përrallë. Nxënësit u ulën sipas grupeve dhe filluan të realizonin maskat me kartona, kurse nxënësit e tjerë mbanin shënim detajet e veshjes, pra kostumografinë që duhet të përgatisnin dhe gjithashtu ata morën masa për të realizuar edhe elemente skenik si dhe muzikën në sfond.
- Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili/a nxënës/e, por dhe unë si mësuese i kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 10 minuta.

- Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup me nga 5 minuta, u vu re që interpretimi, realizimi i kostumografisë, realizimi i maskave përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënës që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë dhe gjithashu u jepet mundësia të njohin mirë njëri-tjetrin dhe karakteristikat e gjithësecilit.

Mësuesja e artit pamor: Sonila Mehmeti

s.mehmeti@gea.edu.al

5. METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës së edukimit fizik, klasa VI, me temë mësimore “Basketboll-Driblimi i topit në vend dhe në lëvizje”, me koncept kryesor realizimin e driblimit të topit, u përdor metoda e punës në grupe. Kjo metodë më mundësoi që të gjithë nxënës të përfshihen në realizimin e detyrave të rekomanduara. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Klasa u organizua në 6 grupe me nga 3 veta secili dhe për secilin grup u ndanë detyrat për drejtuesin dhe anëtarët e tij. Secili grup u pajis me topin e basketbollit dhe me piketa përcaktuese. Nxënës të punuan *mbi realizimin e driblimit të topit në vend dhe në lëvizje*. Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar gjithësecili, por dhe unë si mësuese, pas monitorimit të vazhdueshëm, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 4-5 minuta.
- Më pas, gjatë realizimit të punës së secilit grup, u vu re se përkushtimi i tyre ishte serioz dhe u përmbushën rezultatet e të nxënës që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë për të realizuar rezultatet e të nxënës të vendosur për orën e mësim.

Mësuesja: Xhuljana Adili

xhuljana.adili@gea.edu.al

6. METODA “PUNË NË ÇIFTE”

Në orën mësimore të lëndës së edukimit fizik, klasa V, me temë mësimore “Volejboll: Pasimi i topit me dy duar nga poshtë dhe lart”, me koncept kryesor realizimin e pasimit të topit, metoda ‘punë në çifte’, e parashikuar në planin e orës mësimore mundësoi që të gjithë nxënës të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Mësuesja organizoi klasën në 10 çifte me nga 2 veta secili dhe për secilin çift u ndanë detyrat përkatëse, si dhe secili çift u pajis me topin e volejbollit dhe me piketa përcaktuese për secilin çift.

- Secili çift punoi për detyrën *mbi realizimin e pasimit me dy duar nga poshtë dhe lart*. Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili nxënës/e, por dhe unë si mësuese kam monitoruar, kam ndërhyrë për të vlerësuar nxitur dhe lehtësuar secilin çift në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 4-5 minuta.

U vu re se përkushtimi i tyre ishte i lartë dhe ata përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënit që ishte vendosur për atë koncept të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi të edukimit fizik dhe shëndetsor që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në çifte, sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Xhesila Metalla

xhesila.metalla@gea.edu.al